EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5470
E mërkurë, 8 maj 2018
çmimi 0.40 €

Gjendet trupi i pajetë i policit Armend Trena

Njësitë e kërkim-shpëtimit të FSK-së, të Policisë së Kosovës dhe të Agjencisë së Kosovës për Emergjenca, kanë gjetur të hënën trupin e pajetë të policit të dytë Armend Trena FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MINISTRAT E LISTËS SERBE NUK MARRIN PJESË NË MBLEDHJEN E QEVERISË, POR SHFRYTËZOJNË BUXHETIN E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS DUKE MBAJTUR FUNKSIONET QEVERITARE FAQE 5

Qeveria Haradinaj pret reflektimin e Listës Serbe

Qeveria e Kosovës beson se Lista Serbe do ta rishqyrtojë vendimin për t'u rikthyer në pozitat qeveritare. Halil Matoshi, këshilltar i kryeministrit Ramush Haradinaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se pritjet janë që ky subjekt politik shumë shpejt do të reflektojë në këtë drejtim. Ai ka mohuar se Haradinaj është duke negociuar që Lista Serbe të kthehet në Qeveri me kushte. Kurse njohësit e rrethanave politike në vend dhe opozita e kanë kritikuar sjelljen e Listës Serbe. Sipas tyre, dalja në opozitë e kësaj partie dhe mbajtja e funksioneve qeveritare është përbuzje e sistemit shtetëror

Jack Smithi emërohet kryeprokuror i Gjykatës Speciale

Prokurori amerikan me përvojë në hetime politike të nivelit të lartë dhe hetime penale ndërkombëtare, Jack Smith, është emëruar kryeprokuror i Gjykatës Speciale, pas një procesi përzgjedhës të organizuar nga Bashkimi Evropian. Pas emërimit kryeprokurori Smith ka shprehur gatishmërinë për t'i çuar përpara hetimet. "Është nder dhe kënaqësi që më ofrohet kjo sfidë dhe jam i gatshëm t'i çoj hetimet më tutje", ka thënë Smith FAQE 7

Dita e Evropës filloi në Mitrovicë

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, me rastin e shënimit të Ditës së Evropës, ka bashkëbiseduar të hënën me studentët e Universitetit në Mitrovicë "Isa Boletini", me të cilët ka diskutuar për rëndësinë e kësaj dite dhe për synimet integruese të Kosovës FAQE 3

AKTUALE

SIGUROHEN PAGAT PËR SPECIALIZANTËT F. 6

NDEROHEN HERONJTË FAHRI DHE BAHRI FAZLIU F. 11

BERISHA DHE RAMA VIZITUAN VENDKOMANDËN E USHTRIMIT FUSHOR 'SHQIPONJA 6' F. 5

EKONOMI

SINDIKATA E TELEKOMIT KËRKON SHKARKIMIN E MINISTRIT LLUKA F. 9

FILLON VLERËSIMI I APLIKACIONEVE PËR SUBVENCIONE F. 8

KULTURË

THAÇI DEKORON TENORIN RAMË LAHAJ F. 13

SPORT

JUPA: BESA FAMGAS, PAS KUPËS, KËRKON TITULLIN F. 14

MKRS-ja, 7 200 EURO PËR NISHEVCIN F. 14

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage – Ministry for the Kosovo Security Force
BËHU KADET I FSK-së!
BËHU OFICER I REPUBLIKËS SË KOSOVËS!
KONKURS
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës shpall konkurs për pranimin e kadetëve për Forcën e Sigurisë, për vitin akademik 2018/19, të cilët do të studiojnë në këto qendra:
1) Qendra për Studime Universitare e FSK-së
-Universiteti Amerikan në Kosovë
2) Republika e Turqisë
-Akademia Ushtarake Mjekësore
3) Republika Federale e Gjermanisë
-Kursi i Shkollimit për Oficer Logjistike
-Kursi i Shkollimit për Oficer të Xhenios/Inxhinieri
4) Republika e Maqedonisë
-Akademia Ushtarake
Konkursi do të jetë i hapur prej datës 21 Maj 2018 deri më 08 Qershor 2018
Web: www.mksf-rks.org / Tel: 038- 603-355/199

Holanda, skeptike për nisjen e negociatave me Shqipërinë

TIRANË, 7 MAJ - Në listën e vendeve skeptike për zgjerimin e BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është edhe Holanda. Një delegacion nga Holanda ka mbërritur të hënën në Tiranë për ta parë ecurinë e reformave të ndërmarra deri tani në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian.
Delegacioni i cili përbëhet nga një grup deputetësh është takuar me kryeministrin Edi Rama. Më pas ata janë takuar me kreun e PD-së, Lulzim Basha dhe deputeten Jorida Tabaku. Në një prononcim për mediet pas takimit me Ramën dhe Bashën, ata u shprehën se Shqipëria ende nuk është gati për hapjen e negociatave për integrimin në BE. Deputeti Pieter Omtzigt nga partia Kristian Demokrate u shpreh nuk mjafton vetëm ajo që është bërë, ndërsa kërkuan që zyrtarët e korruptuar të çdo niveli të dalin para drejtësisë. Një tjetër shqetësim i ngritur nga deputetët ishin edhe kriminaliteti shqiptar në Holandë që, sipas tyre, është rritur në vitet e fundit. "Zhvilluam një takim me kryeministrin Edi Rama, kryetarin e PD-së, Lulzim Basha dhe shoqërinë civile. Po shikojmë nëse janë plotësuar kushtet, ndërsa në fund është parlamenti që vendos, pavarësisht prej qëndrimit të Qeverisë. Zyrtarët e korruptuar duhet të vendosen para drejtësisë, ndërsa shqetësim mbetet kriminaliteti shqiptar në Holandë", tha Pieter Omtzigt.

Gjermania, Franca dhe Holanda janë tri vendet skeptike për hapjen e negociatave në fund të qershorit. KE-ja vendosi ta rekomandojë hapjen e negociatave më 17 prill, por deri në fund të qershorit qeveria shqiptare duhet të lobojë fuqishëm për t'i bindur vendet skeptike që të thonë "PO".

Shqipëria, në rrugën drejt anëtarësimit në BE

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, thotë se Shqipëria ndodhet në rrugën drejt anëtarësimit në BE dhe procesi i integrimit, me të gjitha etapat dhe kërkesat e përpikta, mund të jetë evolucionar, por ai po gjeneron rezultate revolucionare

TIRANË, 7 MAJ - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, thotë se Shqipëria ndodhet në rrugën drejt anëtarësimit në BE. "Në qershor Këshilli nuk do të votojë për zgjerimin. Ai do të votojë për vazhdimin dhe thellimin e procesit fondamental të reformave në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Ky proces ka sjellë stabilitet më të madh, më shumë siguri ekonomike dhe përmirësim të marrëdhënieve mes vendeve tona", thotë kryeministri Rama. "Procesi i integrimit në BE, me të gjitha etapat dhe kërkesat e përpikta, mund të jetë evolucionar, por ai po gjeneron rezultate revolucionare. Ta ngadalësosh apo ta ndalosh, tani që vendi ka marrë rekomandim të qartë si kristali për hapjen e negociatave të anëtarësimit, do të ishte e dëmshme dhe e pamundur t'ua shpjegosh qytetarëve tanë, të cilët kanë përkrahur edhe reforma të dhimbshme pasi ata e mbështesin idealin e një Shqipërie evropiane" shton ai. "Në fakt, ne të gjithë së bashku po punojmë shumë, në komunikim, në tregti, në digjitalizim, në promovimin e turizmit, në policim e tjerë. Kjo nuk tërheq kryetituj, natyrisht. Media ndërkombëtare me shumë lehtësi rrëshqet drejt historive të vjetra rreth konflikteve kulturore kur realiteti, në bazë, është shumë i ndryshëm. Pyet çdo 20-vjeçar në Bratislavë, Shkup apo Tiranë për identitetin e tyre kulturor. Ata e kanë jetuar pjesën e tyre më të madhe të jetës si evropianë, me pritshmërinë se, një ditë, vendi i tyre do të jetë anëtar i BE-së", tha tutje Rama.

Pyetjes së parliamentmagazine.eu se si i konsideronte Rama deklaratat e presidentit francez, Emmanuel Macron, për politikën e zgjerimit të BE-së, kryeministri i përgjigjet se "presidenti Macron ishte korrekt". "BE-ja ka nevojë të reformohet. Për më tepër, nëse reformohet BE-ja, edhe ne në Ballkanin Perëndimor duhet ta bëjmë të njëjtën gjë. Këto procese duhet të zhvillohen së bashku. Më lejoni t'ju jap një shembull. Si në shumë vende postkomuniste, edhe ne në Shqipëri kemi pasur një problem të madh me gjyqësorin e korruptuar. Zyrtarët e BE-së na thanë ta zgjidhim. Kështu, së bashku me Brukselin, me ndihmën nga Uashingtoni, ne dolëm me formulën për ta forcuar shtetin e së drejtës dhe institucionet gjyqësore. Tani ka rekomandime që modeli shqiptar të adoptohet në të gjithë Ballkanin Perëndimor", tha Rama.
Ndërsa pyetjes se çfarë e shtyu Komisionin Evropian ta ndryshojë opinion dhe ta rekomandojë hapjen e negociatave me Shqipërinë, Rama i përgjigjet se "kjo erdhi falë programit të reformës në drejtësi, megjithatë është bërë më shumë se kaq. Ndërsa vetëm dy vjet më parë gjendeshim përballë një sfidë të madhe për shkak të dy dekadave të kultivimit të kanabisit, sot kemi shkatërruar pothuajse të tërë këtë industri të jashtëligjshme". "Korrupsioni në Shqipëri përbën ende një problem, por Komisioni e ka gjykuar qartazi Shqipërinë jo si një vend anëtar, por mbi bazën e përpjekjeve që Qeveria po bën për t'i dhënë zgjidhje këtij fenomeni. Negociatat e anëtarësimit do t'i thellojnë më tej reformat dhe rezultatet tona në luftën kundër korrupsionit. Nuk është një problem i cili mund të zgjidhet brenda natës, megjithatë për vite me radhë kemi dhënë shembullin se t'i vjedhësh shtetit do të thotë t'i vjedhësh vetes, dhe nëse dëshirojmë të anëtarësohemi në klubin evropian, duhet të miratojmë një grup të ri rregullash sjelljeje mbi fondet publike", tha Rama.

Marrëveshja me Greqinë, e drejtë dhe e zbatueshme për të dyja palët

TIRANË, 7 MAJ - Marrëveshja me Greqinë ka rëndësi të jetë e drejtë dhe e zbatueshme për të dyja palët.
Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, i pyetur për datat dhe afatet e negociatave me Greqinë, theksoi se "datat dhe afatet janë në thelb motivuese, e njëjta logjikë është e vlefshme dhe në raport me bisedimet që do të zhvillojmë me Greqinë, por nga ana tjetër me rastin në fjalë datat dhe afatet indikative nuk janë qëllim në vetvete". "Është e rëndësishme të kemi një proces të shëndetshëm dhe të shkojmë mundësisht drejt një marrëveshje të re e cila duhet të jetë marrëveshje më e drejtë dhe në fund të ditës e zbatueshme për të dyja palët dhe duhet të jetë një marrëveshje e cila duhet të hapë një kapitull të ri në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë" theksoi Bushati. "Sa i takon aktivitetit që do të organizojë pala greke në mbështetje të kandidaturës së Shqipërisë për t'i nisur bisedimet për anëtarësim, e vlerësojmë këtë gjest mbështetjeje dhe bujar. Greqia është vendi që ka kontribuar për procesin e integrimit", tha Bushati.
Raundi i parë i bisedimeve në mes të Shqipërisë dhe Greqisë për kufizimin e zonave detare u zhvillua më 30 prill në Tiranë. Takimi u zhvillua në një klimë konstruktive dhe bashkëpunuese, thuhej në njoftimin e MEPJ-së. Ndërsa shumë shpejt pritet një raund i dytë takimi në Athinë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Dita e Evropës filloi në Mitrovicë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

MITROVICË, 7 MAJ - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, me rastin e shënimit të Ditës së Evropës, ka bashkëbiseduar të hënën me studentët e Universitetit në Mitrovicë "Isa Boletini", me të cilët ka diskutuar për rëndësinë e kësaj dite dhe për synimet integruese të Kosovës. Në pritje të ministres Hoxha ishte rektori Alush Musa me bashkëpunëtorë, stafi akademik dhe studentët e këtij Universiteti.
Pasi foli për lidhjen e saj të pashkëputshme me Mitrovicën, ministrja Hoxha ka falënderuar të pranishmit për bashkëbisedim, me temë të ardhmen evropiane, rolin e arsimit në të ardhmen dhe perspektivat e tyre si studentë. "Sa i përket së ardhmes tonë, kjo tashmë është e definuar me hyrjen në fuqi të MSA-së. Ne veç kemi bërë hapin e parë zyrtar drejt procesit të integrimit në Bashkimin Evropian. Ritmi me të cilën ne do t'i bashkohemi familjes së madhe evropiane varet në masë të madhe nga ne, nga institucionet e këtij vendi, por edhe nga ju", ka thënë ministrja Hoxha, duke shtuar se rol të rëndësishëm luajnë edhe institucionet dhe shtetet e BE-së.?"Mundësitë për të marrë dije kurrë nuk kanë qenë më të mëdha. Këtu, përpos teknologjisë informative, fjalën e kam edhe tek aplikimi për bursë për studime jashtë vendit", ka thënë ministrja Hoxha, duke u ndalur më gjatë te Projekti Erasmus+ i cili i ka zyrat në Prishtinë dhe në baza ditore pranon studentë që marrin informata për aplikim në shkëmbime afatshkurtra si dhe studime të plota master. Ajo ka bërë me dije se për vitin 2016 dhe 2017, Erasmus+ ka zhvilluar shkëmbime afatshkurtra për stafin dhe studentët që kanë përfituar gjithsej 974 anëtarë të stafit dhe studentë nga Kosova, të cilët kanë shkuar në vendet e BE-së. "460 studentë të huaj kanë ardhur nga shtetet e BE-së për të studiuar apo marrë përvoja akademike në Kosovë dhe 16 studentë për studime të plota në master", është shprehur ajo.
Ministrja Hoxha në fund i ka ftuar studentët t'i përkushtohen së ardhmes, ta zhvillojnë vendin dhe në këtë mënyrë ta integrojnë Kosovën sa më shpejt në strukturat euroatlantike. "Kjo është e ardhmja jonë si komb, individë dhe si rajon", ka thënë ministrja Hoxha.

Haradinaj: Një dekadë miqësi e partneritet me Iowan

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se gati një dekadë Kosova dhe shteti i Iowas kanë demonstruar një partneritet korrekt bashkëpunimi në shumë fusha me interes për Kosovën, veçmas në atë arsimor. "Tani me ardhjen tuaj në Kosovë ky bashkëpunim do të shtohet, për të sjellë rezultate konkrete. Kosova është e hapur për investimet dhe ndihmën amerikane", ka deklaruar Haradinaj gjatë takimit me delegacionin 60 anëtarësh, përfaqësues të shtetit të Iowas, të institucioneve arsimore dhe ekonomike nga ky vend.
Duke vlerësuar marrëdhëniet shumë të mira me shtetin e Iowas, Haradinaj ka thënë se Kosova mburret dhe ka nderin që të ketë partneritet me shtetin e Iowas, në përgjithësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, miqësi kjo e cila ka lindur në ditët më të vështira. "Kosova është shtëpia juaj e dytë dhe kështu ju konsiderojmë. Faleminderit për të gjithë mbështetjen që keni treguar për ne, për shoqërinë tonë. Ardhja juaj këtu sot, dëshmon se ky partneritet, kjo miqësi me ju, po fiton një dimension tjetër, në ekonomi, siguri, kulturë", është shprehur Haradinaj.

Veseli: Verës presim lajmin e madh për vizat

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të hënën në takim delegacionin e Partive Popullore Evropiane, kryesuar nga Andrey Kovatchev. Në këtë takim kryeparlamentari Veseli i informoi deputetët evropianë për progresin e madh që ka bërë Kosova në rrugën e reformave, me theks të veçantë për përmbushjen e gjitha kritereve për liberalizimin e vizave.
Kryeparlamentari Veseli tha se tashmë Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara nga Komisioni Evropian për liberalizimin e vizave, ndërsa theksoi se institucionet kosovare po vazhdojnë punën për reformën e agjendës evropiane e cila do ta sigurojë forcimin e mëtejmë të sundimit të ligjit dhe do të ndikojë në rritjen ekonomike.
Deputetët e Parlamentit Evropian u interesuan për punën e Kuvendit të Kosovës dhe shprehën gatishmërinë e vazhdimit të bashkëpunimit. Ata e njoftuan kryeparlamentarin Veseli se gjatë verës institucionet përkatëse të BE-së do t'i japin sinjalet e qarta sa i përket procesit të liberalizmit të vizave.

Berisha dhe Rama vizituan vendkomandën e ushtrimit fushor 'Shqiponja 6'

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), Rrustem Berisha, dhe komandanti i kësaj force, Rrahman Rama, kanë vizituar të hënën vendkomandën e ushtrimit fushor ndërkombëtar në fshatin Koliq të Prishtinës, ku janë të dislokuar pjesëtarët e FSK-së së bashku me pjesëtarët e ushtrive partnere për ta realizuar ushtrimin fushor "Shqiponja 6", të parin me karakter ndërkombëtar

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

Prishtinë, 7 maj - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Rrustem Berisha, së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), gjenerallejtënant Rrahman Rama, kanë vizituar të hënën vendkomandën e ushtrimit fushor ndërkombëtar në fshatin Koliq të Prishtinës, ku janë të dislokuar pjesëtarët e FSK-së së bashku me pjesëtarët e ushtrive partnere për ta realizuar ushtrimin fushor "Shqiponja 6", të parin me karakter ndërkombëtar.

Në Komandën e Përparme Operacionale, të vendosur në fshatin Koliq, ku ishin të përfaqësuara të gjitha njësitë e ushtrimit fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6", komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), gjeneralbrigade Fadil Hadergjonaj, ka njoftuar për audiencën kryesore të ushtrimit si dhe njësitë pjesëmarrëse.

Gjatë vizitës ministri Berisha dhe gjeneral Rama u njoftuan nga drejtori i ushtrimit fushor, gjeneralbrigade Naim Haziri, me qëllimin, objektivat, skenarin e ushtrimit fushor dhe me aktivitetet që janë paraparë të zhvillohen së bashku me ushtritë e vendeve partnere, Policinë e Kosovës, Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave si dhe Kryqin e Kuq të Kosovës.

Ndërkaq komandanti në detyrë i ushtrimit, nënkolonel Sylejman Cakaj, para ministrit dhe komandantit të FSK-së paraqiti një ekspoze të aktiviteteve dhe operacioneve të zhvilluara që nga dita e dislokimit e deri më sot, si dhe i njoftoi ata me bashkërendimin e veprimeve dhe ndërveprueshmërinë e FSK-së me institucionet vendore dhe partnerët gjatë këtyre ditëve që po zhvillohet ushtrimi. Me këtë rast, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ka përgëzuar stafin planifikues dhe menaxhues të ushtrimit duke shprehur besimin e plotë se skenari i ushtrimit do të realizohet në tërësi dhe se ushtrimi do t'i arrijë objektivat e veta trajnuese.

Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, e ka vlerësuar mjaft të rëndësishme pjesëmarrjen e ushtrive partnere në ushtrim, atë të KFOR-it si dhe të agjencive vendore, duke theksuar se janë me rëndësi komunikimi dhe ndërvepruesh-mëria ndërmjet institucioneve, në mënyrë që ushtrimi ndërkombëtar t'i arrijë objektivat e veta, ashtu siç është planifikuar.

Në Komandën e Përparme Operacionale qëndruan të hënën edhe gjeneralë e oficerë të lartë të FSK-së, të vendeve partnere, atashe të akredituar si dhe zyrtarë të lartë të Presidencës dhe agjencive të sigurisë. Për herë të parë pjesë e këtij ushtrimi, me njësitë dhe përfaqësuesit e tyre, janë edhe shtetet: Shqipëria, Garda e Ajovës dhe Ushtria Amerikane për Evropë (ShBA), Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe KFOR-i, përfaqësuesit e Agjencive të Sigurisë dhe Emergjencave të Kosovës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe Kryqi i Kuq i Kosovës.

Ushtrimi fushor i FSK-së "Shqiponja 6", përveç ushtrimeve të parapara në fshatin Koliq, është duke i vazhduar aktivitetet edhe në Prishtinë, Obiliq, Podujevë, Novobërdë dhe Gjilan.

Ushtrimi fushor "Shqiponja 6" ka filluar më 4 maj dhe do të përfundojë më 11 maj.

Ministrat e Listës Serbe nuk marrin pjesë në mbledhjen e Qeverisë, por shfrytëzojnë buxhetin e institucioneve të Kosovës duke mbajtur funksionet qeveritare

Qeveria Haradinaj pret reflektimin e Listës Serbe

Qeveria e Kosovës beson se Lista Serbe do ta rishqyrtojë vendimin për t'u rikthyer në pozitat qeveritare. Halil Matoshi, këshilltar i kryeministrit Ramush Haradinaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se pritjet janë që ky subjekt politik shumë shpejt do të reflektojë në këtë drejtim. Ai ka mohuar se Haradinaj është duke negociuar që Lista Serbe të kthehet në Qeveri me kushte. Kurse njohësit e rrethanave politike në vend dhe opozita e kanë kritikuar sjelljen e Listës Serbe. Sipas tyre, dalja në opozitë e kësaj partie dhe mbajtja e funksioneve qeveritare është përbuzje e sistemit shtetëror

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 MAJ - Qeveria e Kosovës pret që Lista Serbe të reflektojë së shpejti dhe të kthehet në koalicionin qeverisës, ndonëse zyrtarët qeveritarë e kanë mohuar mundësinë se është duke u negociuar një gjë e tillë. Ndërsa veprimet e këtij subjekti politik, duke u sjell si opozitë dhe duke i mbajtur funksionet qeveritare, janë kritikuar nga njohësit e rrethanave politike në vend dhe përfaqësuesit e opozitës.

Halil Matoshi, këshilltar i kryeministrit Ramush Haradinaj, ka thënë se Qeveria beson se shumë shpejt Lista Serbe do ta rishqyrtojë vendimin për tërheqjen nga Qeveria. "Qeveria e udhëhequr nga kryeministri Haradinaj ka besim të plotë se Lista Serbe do ta rishqyrtojë vendimin e vet për tërheqjen nga Qeveria. Qëndrimi i tyre në postet qeveritare që i kanë të garantuar me Kushtetutë u mundëson atyre të luftojnë për të drejtat e tyre të ligjshme dhe për mirëqenien e bashkëqytetarëve të tyre. Prandaj, z. Haradnaj ka raporte korrekte me përfaqësuesit e Listës Serbe dhe shpresojmë se ata së shpejti do të kthehen në Qeveri", ka thënë Matoshi për gazetën "Epoka e re".

Ai ka mohuar se Qeveria është duke negociuar me këtë subjekt politik për ta rishqyrtuar kthimin e saj në kabinetin qeveritar. "Kryeministri Haradinaj nuk ua ka pranuar dorëheqjen, negocim për këtë çështje nuk ka, sikurse nuk ka as kushte për këtë çështje. Ne shpresojmë se ata së shpejti do të reflektojnë dhe do të kthehen në Qeveri", është shprehur Matoshi.

Sjellja e Listës Serbe është kritikuar nga analistët politikë dhe përfaqësuesit e opozitës. Sipas tyre, Lista Serbe po e shfrytëzon maksimalisht situatën politike të krijuar në vend. "Ata janë duke e shfrytëzuar rastin, sepse e kanë gjetur butë. Askush nuk po u thotë asgjë. Kryeministri nuk po ndërmerr masa, koalicioni po varet prej tyre dhe ata po e shfrytëzojnë këtë rast, në mënyrë që të përfitojnë poste dhe privilegje. Pra, nëse nuk ndërmerr masa kryeministri apo në përgjithësi institucionet përkatëse, ata mund të vazhdojnë kështu edhe për 10 vjet të tjera. Thjesht, ata janë duke e shfrytëzuar situatën e krijuar", ka thënë për "Epokën e re" analisti Imer Mushkolaj.

Ai ka vlerësuar se kjo është një situatë që nuk ka çfarë të bëjë as pozita e as opozita. "Problemi është se koalicioni qeverisës varet prej tyre. Ata nuk po duan as mish e as peshk. Pra, nuk po duan as në pushtet e as në opozitë. Po i marrin përfitimet prej pushteti, por nuk po duan t'i ndihmojnë opozitës në këtë rast. Është një situatë që nuk ka çka bën as pushteti e as opozita. Ata thjesht po luajnë me Qeverinë dhe institucionet e Kosovës qysh po duan", ka thënë Mushkolaj.

Edhe deputeti i Grupit të Pavarur të Deputeteve, Dukagjin Gorani, një situatë të tillë e ka vlerësuar paradoksale. Ai ka thënë për "Epokën e re" se diçka e tillë është përbuzje e sistemit shtetëror. "Është situatë paradoksale kjo në Kuvend, ku opozita e kontrollon shumicën. Po ashtu, mbetet i paqartë roli i Listës Serbe në koalicionin qeveritar: sillet si opozitë, por mban funksione qeveritare. Diçka e tillë është përbuzje e sistemit shtetëror, por edhe arrogancë publike e këtyre përfaqësuesve të komunitetit serb", ka thënë Gorani.

Pas arrestimit të Marko Gjuriqit në veri të Mitrovicës nga Policia e Kosovës, Lista Serbe kishte bërë me dije se do të largohet nga Qeveria e Kosovës. Pas këtij lajmi, të cilin e dhanë në Beograd, pas takimit me presidentin serb, edhe deputetët e këtij subjekti politik kanë filluar të sillen si opozitarë. Pavarësisht prej këtij qëndrimi, Lista Serbe nuk hoqi dorë prej privilegjeve që ia jep pushteti. Edhe më tutje ministrat e këtij subjekti politik vazhdojnë të dalin në vendet e tyre të punës, i marrin pagat dhe i shfrytëzojnë veturat zyrtare.

Hykmete Bajrami: Kriza institucionale po shfaqet në forma të ndryshme

PRISHTINË, 7 MAJ - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka deklaruar në "Info Magazine" te "Klan Kosova", se Qeveria e Ramush Haradinajt qysh nga dita e parë ka qenë e varur nga Lista Serbe dhe kështu vazhdon të jetë. "Kemi pritur me orë të tëra derisa Lista Serbe të vijë nga Beogradi dhe ta votojë kryeministrin Haradinaj", ka thënë Bajrami.

Ajo ka pohuar se LDK-ja vazhdimisht ka pasur pak besim që Qeveria e Haradinajt mund t'i lëvizë proceset e rëndësishme për vendin. "Gjithmonë kemi qenë skeptikë se do të kemi një qeveri që do të mund t'i çojë proceset përpara. Varësia nga Lista Serbe është shpërfaqur që nga dita e parë. Koalicioni qeverisës sot është pakicë në Kuvend dhe pozicioni i Listës Serbe është shantazhues", ka thënë ajo.

Bajrami ka shtuar se së fundmi kemi parë edhe mosfunksionim të Kuvendit. "Është shumë e rrezikshme që për çdo vendim në Kuvend të varesh nga Lista Serbe. Prandaj, kriza institucionale po shfaqet në forma të ndryshme", ka thënë Bajrami.

Partitë Popullore Evropiane konfirmojnë përkrahjen për Kosovën

Prishtinë, 7 maj (ER) - "Kosova është e përkushtuar t'i përmbushë të gjitha obligimet për t'u përafruar me agjendën evropiane dhe rruga e saj e vetme është integrimi euroatlantik", kështu tha kryeministri Ramush Haradinaj të hënën pasi priti në takim delegacionin e Partive Popullore Evropiane, kryesuar nga Andrey Kovatchev, Asim Ademov dhe Elmar Brok.
Kryeministri Haradinaj ka njoftuar përfaqësuesit e Parlamentit Evropian për të arriturat e vendit për fuqizimin e sundimit të ligjit, nismën për reformën në administratën publike, për avancimin e raporteve për një fqinjësi të mirë, nevojën e përmbylljes së bisedimeve me Serbinë dhe progresin e arritur në fushën ekonomike të vendit. "Anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian është vital për stabilitetin, sigurinë dhe progresin e vendit dhe të tërë rajonit. Mbështetja e partive popullore për Kosovën në Parlamentin Evropian është e rëndësisë së veçantë që rrugëtimi ynë të rezultojë me sukses", tha kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Bashkimi Evropian duhet t'i hapë rrugë Kosovës për anëtarësim në familjen evropiane së cilës i takojmë dhe në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë.
Kryeministri Haradinaj ka konfirmuar para delegacionit të Partive Popullore Evropiane që Kosova po përmbushë agjendën e saj evropiane dhe ka kërkuar nga ta mbështetjen për procesin e liberalizimit të vizave.
Përfaqësuesit e Partive Popullore të Parlamentit Evropian përgëzuan kryeministrin e Kosovës për të arriturat e vendit në këto vite të ekzistencës si shtet dhe ofruan mbështetjen e tyre në proceset e integrimit të vendit.

Konservimi i kullës së Jasharëve, peng i ligjit

Prishtinë, 7 maj - Shefi i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, Idriz Blakaj, ka thënë të hënën se konservimi i kullës së Jasharëve në Prekaz ka mbetur peng i një ligji që e rregullon çështjen e këtij kompleksi.
Gjatë marsit gjendja e rënduar e kompleksit të Jasharëve qe bërë temë diskutimi në opinion për shkak të paralajmërimeve se kulla mund të shkatërrohet si pasojë e mungesës së menaxhimit adekuat tash e 19 vjet. "Është e vërtetë se kanë mbetur keq dhe kullat janë keq. Plot njerëz vitin e kaluar kanë bërë zhurmë", ka thënë Blakaj para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Mjedis. "Unë kisha dëshirë që të bëhet ajo zhurmë, sepse thashë bëhet diçka dhe kalon ligji. Tenderimi për konservimin e kullave nuk mund të bëhet pa ardhur ligji", është shprehur ai.
Një problem tjetër për konservimin e këtij kompleksi, sipas Blakajt, është edhe në çështje profesionale. "Arkitekt për konservim nuk ka në Kosovë. Unë nuk di që ka. Andaj ligji nuk mund të lejojë të bëhet konservimi pa qenë ekspert i kësaj fushe", ka thënë Blakaj.

Sigurohen pagat për specializantët

> Duke mbajtur premtimin që kemi dhënë në fillim të mandatit tonë, me rregullimin e kësaj padrejtësie, e cila ka ndodhur për vite me radhë, unë zotohem se kushtet e personelit tonë mjekësor do të përmirësohen vazhdimisht", ka thënë ministri Ismaili.

Prishtinë, 7 maj (ER) - Ministri i Shëndetësisë (MSh), Uran Ismaili, ka bërë me dije se nga dita e hënë ka hyrë në sistem pagesa e qindra specializantëve vullnetarë të mjekësisë. Ai ka thënë se një gjë e tillë është bërë e mundur falë ndryshimit të një udhëzimi administrativ. "Jam shumë i lumtur që sot, pas një pune shumë të madhe që kemi bërë, po i fusim në pagesë qindra specializantë vullnetarë. Duke mbajtur premtimin që kemi dhënë në fillim të mandatit tonë, me rregullimin e kësaj padrejtësie, e cila ka ndodhur për vite me radhë, unë zotohem se kushtet e personelit tonë mjekësor do të përmirësohen vazhdimisht", ka thënë ministri Ismaili. Ai ka shtuar se përmes këtij plotësim-ndryshimi të Udhëzimit Administrativ, të gjithë specializantët fitojnë të drejtën e tyre për t'u paguar nga shteti dhe të drejtën për t'u trajtuar të barabartë. "Vendi ynë ka nevojë për kuadrot e saj, andaj përmes krijimit të kushteve ne do t'i mbajmë ata në vendin tonë", ka thënë ministri Ismaili.

Fakulteti Filozofik organizon tryezë për Ditën e Evropës

Prishtinë, 7 maj (ER) - Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në bashkëpunim me Friedrich Ebert Stiftung, për nder të ditës së Evropës, më 9 maj, organizon tryezën me temë "Integrimi i pjesshëm apo i tërësishëm i Ballkanit Perëndimor në BE".
Në këtë tryezë, përveç personelit akademik të UP-së, do të jenë të pranishëm edhe të ftuar të tjerë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe njohës të fushave që lidhen me procesin e përafrimit dhe integrimit në Bashkimin Evropian.
Tryeza fillon nga ora 9:00 në ambientet e Fakultetit Filozofik, salla nr. 302.

Jack Smithi emërohet kryeprokuror i Gjykatës Speciale

Prokurori amerikan me përvojë në hetime politike të nivelit të lartë dhe hetime penale ndërkombëtare, Jack Smith, është emëruar kryeprokuror i Gjykatës Speciale pas një procesi përzgjedhës të organizuar nga Bashkimi Evropian. Pas emërimit kryeprokurori Smith ka shprehur gatishmëri për t'i çuar përpara hetimet. "Është nder dhe kënaqësi që më ofrohet kjo sfidë dhe jam i gatshëm t'i çoj hetimet më tutje", ka thënë Smith

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 7 maj - Prokurori amerikan Jack Smith është emëruar të hënën kryeprokuror i Dhomave të Veçanta apo Gjykatës Speciale për Krime Lufte. Smithi është emëruar në këtë post pas një procesi të përzgjedhjes që është organizuar nga Bashkimi Evropian (BE). Siç është bërë me dije në njoftimin e Gjykatës Speciale, Smithi ka përvojë në hetime politike të rangut të lartë dhe hetime penale ndërkombëtare. Prokurori Smith do të jetë pasardhës i David Schvendimanit, i cili ishte kryeprokurori i parë, por e kishte lëshuar detyrën më 31 mars kur skadoi emërimi i tij zyrtar i shërbimit të jashtëm amerikan.

Pas emërimit kryeprokurori Smith ka bërë me dije se është i gatshëm t'i çojë përpara hetimet. "Është nder dhe kënaqësi që më ofrohet kjo sfidë dhe jam i gatshëm t'i çojë hetimet më tej", është shprehur Smith, sipas një njoftimi të Gjykatës Speciale. Me këtë rast, kryetarja e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova, ka vlerësuar se emërimi i Jack Smithit në postin e Prokurorit të Specializuar do të ndihmojë në avancimin e mandatit të gjykatës.

Kryetarja Trendafilova ka thënë se Smithi ka përvojën e duhur në fushën e hetimeve penale në nivel ndërkombëtar. "I ofroj z. Smith përgëzimet e mia të sinqerta me rastin e emërimit të tij dhe kam besim që përvoja e tij e gjatë në fushën e hetimeve dhe ndjekjeve penale, si në Shtetet e Bashkuara ashtu dhe në nivel ndërkombëtar, do të shërbejë për përmbushjen e mandatit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Do ta kem kënaqësinë të krijoj marrëdhënie të frytshme pune me z. Smith dhe kam besim se Zyra e Prokurorit të Specializuar do të bëjë përparim të mëtejshëm në drejtim të përmbushjes së mandatit të saj", ka deklaruar kryetarja Trendafilova.

Mandati i Gjykatës Speciale për Krime Lufte përkufizohet kryesisht në hetimet dhe gjykimet e rasteve të pretenduara të krimeve të luftës nga ana e disa ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe kundërshtarëve, që përfshin periudhën kohore nga viti 1998 e deri në fund të vitit 2000. Kjo gjykatë u krijua pas ndryshimeve kushtetuese nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2015. Edhe pse ende nuk ka ndonjë njoftim zyrtar se kur mund të ngrihen aktakuzat e para, pritet kjo të ndodhë këtë vit.

Biografia e kryeprokurorit të Gjykatës Speciale

Prokurori i ri i Gjykatës Speciale, Jack Smith, ka një të kaluar të gjatë në sistemin e drejtësisë amerikane. Ai ka qenë i angazhuar në mekanizma të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë. Nga shkurti i vitit 2015 deri në gusht të vitit 2017 prokurori Smith ishte ndihmësprokuror i parë federal dhe ushtrues i detyrës së prokurorit federal për rajonin e mesëm në Tenesi. Gjatë periudhës 2010-2015 Smithi ishte kreu i seksionit për integritet publik në Departamentin e Drejtësisë së ShBA-së.

Smithi ka qenë i angazhuar edhe në Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Nga viti 2008 deri në vitin 2010 pranë kësaj gjykate ai mbikëqyri hetime delikate të zyrtarëve të qeverive të ndryshme dhe të milicisë, për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Sipas njoftimit të Gjykatës Speciale, Smithi ka qenë i angazhuar edhe në pozita të tjera të rëndësishme, ndërkohë që ka diplomuar në Fakultetin Juridik të Harvardit dhe në Universitetin Shtetëror të Nju Jorkut në Oneonta.



Gjendet trupi i pajetë i policit Armend Trena

Hani i Elezit, 7 maj - Njësitë e kërkim-shpëtimit të FSK-së, të Policisë së Kosovës dhe të AME-së (Agjencisë së Kosovës për Emergjenca) të hënën në orën 15:40, në kilometrin e gjashtë (në hyrje të Hanit të Elezit) nga vendi i aksidentit në lumin Lepenc, kanë gjetur trupin e pajetë të policit Armend Trena.

Policët Armend Trena dhe Malsor Dashi kishin rënë më 28 prill në lumin Lepenc teksa po udhëtonin me veturën zyrtare në magjistralen Hani i Elezit - Kaçanik.

Trupi i pajetë i policit Malsor Dashi është gjetur nga ekipet e zhytësve dhe vullnetarëve më 3 maj. Ngushëllime familjes Trena, me rastin e gjetjes së trupit të pajetë të policit, Armend Trena, i kanë shprehur zyrtarët e lartë shtetërorë dhe përfaqësues të partive politike.

Beqaj: Gjermania, donatorja më e madhe bilaterale në Republikën e Kosovës

PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka marrë pjesë të hënën në tryezën e organizuar me rastin e shënimit të 10-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike në mes të Kosovës dhe Gjermanisë. "Gjermania, përmes taksapaguesve të vet, është donatorja më e madhe bilateral në Republikën e Kosovës dhe kjo është për t'u respektuar, sepse me vite të tëra në shumë sektorë ka pasur angazhim të madh për mirëqenien e qytetarëve të Kosovës", ka thënë Beqaj.

Beqaj ka folur edhe për prioritetet dhe angazhimet e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për hapjen e mundësive për zhvillim ekonomik të Kosovës, duke specifikuar se Ministria që ai drejton është në fazën e përgatitjes së kornizës ligjore me anë të së cilës do të trajtohen inovacioni dhe ndërmarrësia në Kosovë. "Rruga e futjes së konkurrueshmërisë në Kosovë duhet të shkojë përmes inovacionit dhe ndërmarrësisë, përmes sektorit privat", ka thënë Beqaj, duke vlerësuar lart rëndësinë e përkrahjes së këtij sektori që, sipas tij, po bën revolucion të ri industrial në botë, i cili duhet të shoqërohet me një sërë veprimesh institucionale, në veçanti në fushën e edukimit.

Fillon vlerësimi i aplikacioneve për subvencione

PRISHTINË, 7 MA (ER) - Për programin e pagesave direkte 2018, për të cilin janë planifikuar 25 milionë euro, kanë aplikuar 28 139 fermerë nga 37 komuna të Kosovës, me gjithsej 46 865 aplikacione për 58 kultura dhe veprimtari të ndryshme bujqësore.

Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), Elhami Hajdari, ka thënë se menjëherë pas përfundimit të procesit të aplikimit dhe pranimit të aplikacioneve nga të gjitha komunat, Drejtoria e Pagesave Direkte në AZhB ka filluar procesin e kontrollit administrativ. "Deri më tani Drejtoria e Pagesave Direkte ka kryer kontrollin administrativ për mbi 4 500 aplikacione, ndërkaq procesi është duke vazhduar edhe gjatë këtyre ditëve. Ndërsa për aplikacionet për të cilat ka përfunduar kontrolli administrativ, tashmë inspektorët e agjencisë janë duke kryer edhe procesin e radhës, atë të kontrollit në terren, ku deri më tani janë përfunduar mbi 500 aplikacione, kryesisht për kulturën e grurit dhe për bletët", ka thënë Hajdari.

Ai ka treguar se fermerët kanë pasur të drejtë aplikimi për më shumë se një kulturë bujqësore, prandaj edhe numri i aplikacioneve është më i madh.

Bizneset paralajmërojnë padi kundër KEDS-it

PRISHTINË, 7 MAJ - Bizneset e pakënaqura në rajone periferike të Kosovës janë duke planifikuar që ta padisin KEDS-in për trajtim të pabarabartë me furnizim me energji elektrike. Sipas disa përfaqësuesve të bizneseve, furnizimi i tyre me energji elektrike është i çrregulluar dhe po dëmton bizneset e tyre.

Bizneset nga rajonet e ndryshme të Kosovës konsiderojnë se po u bëhet padrejtësi nga ana e KEDS-it, pasi po furnizohen me më pak rrymë sesa kryeqendra. Për këtë arsye, Burim Piraj, me fabrikën e tij në Dragash, ka pohuar se janë duke planifikuar ngritjen e një padie kundër KEDS-it. "Kemi bashkëpunim me shoqatat e biznesit, jemi duke punuar në këtë drejtim që të bëhet një padi kolektive e disa bizneseve kundër KEDS-it dhe të kërkohet llogari. Pse të mos kërkohet llogari kur jemi shumë parapagues të rregullt të energjisë elektrike dhe ata nuk kanë problem me neve për pagesë, ashtu edhe ne duhet të mos kemi problem me ta për furnizim me energji elektrike", ka thënë Piraj.

Por nuk është vetëm ky rajon i pakënaqur me trajtimin nga KEDS-i. Pakënaqësi kanë shprehur edhe bizneset nga rajoni i Ferizajt. Një ndër ta është prodhuesi Bekim Musliu. "Ka probleme me rrymë. KEDS-i dhjetë herë e ndalë rrymën, një herë të lajmëron që ka ndalje të rrymës. Nuk të lajmëron me kohë, veç kur t'i teket e ndalë rrymën", është shprehur ai për "Radio Kosova".

Por zëdhënësi i KEDS-it, Viktor Buzhala, ka thënë se njoftimet për ndalje të rrymës bëhen rregullisht. Ai ka thënë se nuk ka reduktime të energjisë elektrike. "Ju garantoj se KEDS-i nuk është duke aplikuar reduktime jo vetëm për biznese, por për asnjë konsumator anekënd territorit të vendit", ka thënë Buzhala.

Sindikata e Telekomit kërkon shkarkimin e ministrit Lluka

Sindikata e Punëtorëve të Telekomit ka kërkuar nga kryeministri Ramush Haradinaj ta shkarkojë ministrin e Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Valdrin Lluka, pas deklaratës së tij për gjendjen në Telekom, veçanërisht asaj të uljes së pagave të punëtorëve. Këshilltari i ministrit Lluka, Ibrahim Rexhepi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kërkesat e kësaj sindikate janë absurde pasi, sipas tij, kjo sindikatë kërkon ruajtjen e privilegjeve dhe përfitimeve, e jo shpëtimin e kompanisë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 PRILL - Sindikata e Punëtorëve të Telekomit të Kosovës ka reaguar pas deklaratave të fundit të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, se disa punëtorëve të kësaj kompanie do t'u ulen pagat deri në 40 për qind. Në komunikatën për media thuhet se, siç jeni në dijeni për zhvillimet e fundit që po ndodhin në Telekomin e Kosovës dhe deklaratat e papërgjegjshme të ministrit të MZhE-së, Valdrin Lluka, për sindikatën janë të papranueshme, qëllimkëqija dhe shumë demotivuese për të gjithë punëtorët e TK-së. "Pa i njohur problemet dhe vështirësitë e TK-së, pa u marrë me një analizë se si duhet të dilet nga kjo gjendje, ku ka plot mundësi që kompania të funksionojë me fitim të vetin, duke rishikuar të gjitha kontratat e dëmshme: 'Z-Mobile', kontratat për qiranë dhe pikat shitëse, ulja e shpenzimeve të derivateve, investimet e domosdoshme për gjenerim të të hyrave dhe ndërprerja e punësimeve që ende po vazhdon etj. Andaj kërkojmë nga kryeministri z. Ramush Haradinaj ta shkarkojë ministrin Lluka për këto deklarata të panevojshme dhe demotivuese që për pasojë kanë rritur demotivimin e punëtoreve për punë duke kërcënuar me ulje të pagave dhe falimentim të TK-së", thuhet në komunikatën e dërguar për media.

Aty thuhet se sindikata në fjalë nuk do të pranojë të degradohen punëtorët duke u kërcënuar në forma të ndryshme pasi, sipas tyre, më së paku punëtorët janë përgjegjës për këtë gjendje, ku dihet roli i politikës në të gjitha emërimet e KE-ve dhe bordeve e që asnjëherë nuk e ka marrë kush përgjegjësinë për degradimin e kompanisë. "Andaj, në rast se nuk merren masa ndaj ministrit Lluka, ne nuk i përjashtojmë të gjitha format e protestës siç na garanton edhe Ligji Sindikal i Republikës Kosovës", është thënë në reagimin e Sindikatës së Punëtoreve të Telekomit.

Lidhur me këtë, këshilltari i lartë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ibrahim Rexhepi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kërkesa e Sindikatës së Telekomit për shkarkimin e ministrit Lluka është absurde. "Sindikatat e kanë autonominë e tyre të veprimit dhe mund të shtrojnë çfarëdo kërkese. Por, kjo nuk do të thotë se ata gjithmonë ia qëllojnë dhe se gjithmonë kanë të drejtë. Në rastin konkret, është absurde kërkesa për shkarkimin e ministrit Lluka, meqenëse ai që nga dita e parë e punës në këtë funksion është angazhuar për gjetjen e zgjidhjes më të mirë për Telekomin e Kosovës. Madje jo vetëm përmes shkurtimit të shpenzimeve për pagat e përfitimet e tjera, por me një program gjithëpërfshirës. Po ashtu, ai asnjëherë nuk ka thënë se vetëm ulja e pagave e shpëton kompaninë, por vetëm rishikimi i pagave përbrenda një pakoje masash", ka thënë Rexhepi, duke shtuar se është e pakuptueshme qasja që ka Sindikata e Telekomit, meqenëse ajo kërkon ruajtjen e privilegjeve dhe të përfitimeve, e jo shpëtimin e kompanisë. "Qasja e tillë nuk ofron zgjidhje, por vetëm e thellon krizën. Prandaj, më e arsyeshme do të ishte që edhe sindikata të kyçet në frontin e përpjekjeve për shpëtimin e kompanisë, e jo të qëndrojë kokëfortë në mbrojtjen e qasjeve që e sollën Telekomin në këtë pozitë", ka thënë Rexhepi, duke shtuar se Ministria e Zhvillimit Ekonomik është në bashkëpunim të ngushtë me Bordin e Telekomit me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve më të mira dhe të qëndrueshme. "Prandaj, edhe do t'i përkrahë të gjitha masat e arsyeshme dhe shpresëdhënëse që ofron Bordi. Do të thotë, ne nuk do të ndërhyjmë padrejtësisht në punët e kompanisë, por as nuk do të qëndrojmë duarkryq në situatën kur Telekomi po rrënohet. Tekefundit, MZhE-ja dhe ministri kanë përgjegjësi ligjore që të ndërhyjnë në situata të këtilla", ka thënë Rexhepi.

Inspektorati komunal në Malishevë merr vendim për rrënim të objekteve montazh

MALISHEVË, 7 MAJ (ER) - Pas urdhëresave nga Ministria e Mbrojtjes dhe Planifikimit Hapësinor, për rrënimin e objekteve montazh, drejtoria e Inspektoratit e Komunës së Malishevës ka marrë vendim për rrënimin e të gjitha objekteve montazh tek Ujëvara e Mirushës, e cila gjendet në zonën e parë mbrojtëse. "Drejtoria e Inspektoratit e Komunës së Malishevës ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore, duke urdhëruar pronarët t'i largojnë objektet brenda afatit prej 30 ditësh. Në rast të mosveprimit nga pronarët, inspektorati do t'i rrënojë objektet, por të gjitha shpenzimet do t'i bartin pronarët. Tërheqim vërejtjen, si inspektorat, se të gjitha objektet të cilat janë të ndërtuar në zona ku nuk lejohet do të merren masa ligjore nga inspektorati, për rrënimin e atyre objekteve", është thënë në njoftimin e Komunës së Malishevës.

Demush Mavraj ra siç bien trimat në altarin e lirisë

ISTOG, 7 MAJ (ER) - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, njëherësh anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Adem Grabovci, ka përkujtuar dëshmorin Demush Mavraj me rastin e 19-vjetorit të rënies së tij. Grabovci përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Demushin e kishte bashkëvendës, shok, mik dhe bashkëluftëtar. "Sot bëhen 19 vjet nga rënia heroike e dëshmorit të kombit, Demush Mavraj. Demushin e kisha bashkëvendës, shok, mik dhe bashkëluftëtar. Që në takimin e parë që pata me të, Demushi iu bashkua me entuziazëm të madh dhe përkushtim radhëve të UÇK-së, duke u bërë shembull për shumë të rinj dhe të reja të kësaj ane të Dukagjinit. Ai ra siç bien trimat në altarin e lirisë, për ta fituar pavdekësinë", ka shkruar Grabovci.

Komuna e Prizrenit ofron lehtësira për regjistrimin e veturave

Prishtinë, 7 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë me dije se nga dita e hënë qytetarët që duhet t'i regjistrojnë veturat e tyre do të kenë lehtësim në shërbime komunale. "Për regjistrimin e veturës duhet të paguhet taksa komunale rrugore në shumë prej 10 eurosh në Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa, ndërsa për ta kryer këtë pagesë deri më tash duhej të shkohej në sportelet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike në ndërtesën komunale për ta marrë faturën e menaxhimit të mbeturinave. Tani qytetarët faturën e menaxhimit të mbeturinave mund ta marrin në sportelin numër 8 në Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa, ku edhe do ta kenë mundësinë ta kryejnë pagesën dhe menjëherë më pas ta paguajnë edhe taksën rrugore komunale, pa pasur nevojë të enden në Drejtorinë e Shërbimeve Publike", ka thënë Haskuka.

S'do të ketë leje për shfrytëzimin e hapësirave përreth liqenit artificial në Suhadoll

MITROVICË, 7 MAJ (ER) - Bordi i drejtorëve të Komunës së Mitrovicës ka mbajtur mbledhjen e rregullt javore në të cilën ka diskutuar për problemet në këtë komunë. Mbledhjen e ka drejtuar nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, ku është njoftuar nga drejtorët e drejtorive rreth problemeve me të cilat eventualisht ballafaqohen në punën e tyre të përditshme, me qëllim që bashkërisht të kërkohen zgjidhje për tejkalimin e tyre.

Në takim u diskutua për lëndët përmbarimore dhe kthimin e përgjigjeve në shkresat që i dërgon Drejtoria e Financave, me qëllim që të saktësohen kërkesat e përmbaruesve dhe obligimet e realizuara të drejtorive, në mënyrë që mos të ndryshojnë pagesat.

Bordi i drejtorëve ka diskutuar edhe për Rregulloren për Taksa Komunale, gjoba dhe tarifa. Edhe në këtë takim të bordit u diskutua për lejet për shfrytëzimin e hapësirave publike përreth liqenit artificial në Suhadoll. Rreth kësaj çështje u tha se që të mos lëshohen leje për shfrytëzim të kësaj hapësire, para se të bëhen edhe zgjidhjet e tjera përkatëse lidhur me mirëmbajtjen e hapësirave.

Nisma themelon edhe një nëndegë të re në Gjilan

Gjilan, 7 maj (ER) - Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, njëherësh ministër i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka thënë se ky subjekt politik po merr përkrahjen e qytetarëve të Gjilanit. Këtë deklaratë Hasani e ka dhënë pas formimit të një nëndege të re të Nismës në fshatin Llashticë të Gjilanit.

Kryetar i kësaj nëndege u zgjedh Ilir Ramushi.

Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Bajram Hasani, ka thënë se puna dhe përkushtimi i anëtarëve të të gjitha strukturave dhe simpatizantëve po bën që Dega e Nismës në Gjilan të ketë rritje gjithnjë e më masive.

Nderohen heronjtë Fahri dhe Bahri Fazliu

"Fahriu ra dëshmor në fillimet e lëvizjes sonë kombëtare për çlirimin e Kosovës, bashkë me ideologun e lëvizjes studentore, Afrim Zhitinë. Ata u bënë shembull i guximit dhe sakrificës për atdhe për të gjithë ne. Bahriu nuk u dekurajua nga humbja e vëllait të tij. Vazhdoi edhe më fuqishëm aktivitetin ilegal. Ishte njeri i penës dhe i pushkës", ka thënë kryeparlamentari Kadri Veseli me rastin e 20-vjetorit të rënies së heroit Bahri Fazliu

PODUJEVË, 7 MAJ (ER) - Në 20-vjetorin e rënies së heroit të Kosovës, Bahri Fazliu, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule te lapidari i heronjve Fahri dhe Bahri Fazliu. Kryeparlamentari Kadri Veseli në fjalën e tij ka thënë se historikisht familjet e Kosovës kanë qenë qendër e rezistencës për liri. Sipas tij, një nga dëshmitë më të fuqishme të këtij fakti është familja Fazliu nga Llausha e Podujevës, në të cilën u rritën dy heronj të lirisë, Fahri dhe Bahri Fazliu. Veseli ka shtuar se Fahriu e Bahriu kanë vepruar në një kohë kur të paktë ishin ata që besonin tek lufta për liri. "Fahriu ra dëshmor në fillimet e lëvizjes sonë kombëtare për çlirimin e Kosovës, bashkë me ideologun e lëvizjes studentore, Afrim Zhitinë. Ata u bënë shembull i guximit dhe sakrificës për atdhe për të gjithë ne. Bahriu nuk u dekurajua nga humbja e vëllait të tij. Vazhdoi edhe më fuqishëm aktivitetin ilegal. Ishte njeriu i penës dhe i pushkës", ka deklaruar Veseli.

Ai ka theksuar se 20 vjet më parë Bahriu ra dëshmor njësoj si Fahriu, por rruga për të cilën ai jetoi e veproi tanimë ishte hapur. "Rruga e lirisë ishte bërë e pakthyeshme falë veprimtarisë atdhetare të djemve të tillë si Fahri e Bahri Fazliu. Ne do t'i nderojmë gjithmonë, sepse përgjithmonë do të jetojë vepra e tyre e madhe: liria dhe pavarësia e Kosovës", është shprehur Veseli.

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se në LKÇK dikur ka njohur djemtë më të pastër shqiptarë, për nga ideali i lirisë dhe ai kombëtar, duke thënë se nga përvoja tij me ata që i ka njohur, gjatë dhe pas luftës vërtet ka gjetur tek ta një pastërti të jashtëzakonshme të idealit kombëtar dhe të lirisë. "Diçka që kombin tonë e nderon ashtu siç e nderojnë Ukshin Hoti, Bahri Fazliu si dhe ata burra të cilët gjatë rrugës së tyre jetësore na kanë dhënë mundësinë, që ne të thirremi në këto rrugë dhe në këto argumente", është shprehur Haradinaj.

Ai ka theksuar se mbamendja historike që e krijojmë në këtë përvjetor e ka vlerën e vet. "Në këto vende të shënuara të historisë sonë ia vlen për t'u bashkuar të gjithë ngado që vijmë, pa marrë parasysh edhe sot çfarë përkatësish kemi, qoftë politike apo të tjera, një përkatësi nuk ndërron, jemi të këtij vendi, jemi shqiptarë, jemi në të drejtën tonë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke shtuar se duke i konsoliduar të arriturat e tashme nuk do të dalin nga rruga e dëshmorëve dhe atdhetarëve tanë. "Nëse shkojmë nga një konsolidim i kujdesshëm i të arriturave, pikërisht sakrificës dhe gjakut të Bahriut, Fazliut, Luanit e të tjerëve, ne krijojmë bazë për etapat e ardhshme për të drejtën tonë, si shqiptarë në trojet tona në Ballkan", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Në emër të familjes Fazliu të pranishmit i përshëndeti nipi i Bahri Fazliut, Fahri Fazliu i ri.

'Ec ma ndryshe': Komuna e Prishtinës, më transparentja

Organizata "Ec ma ndryshe" ka publikuar të hënën Indeksin e Reformës së Transparencës Komunale, ku Komuna e Prishtinës del komuna me nivelin më të lartë të transparencës gjatë vitit 2017.



PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Indikatorët që janë monitoruar dhe në të cilët është bazuar ky Indeks janë: kryetari, drejtorët dhe anëtarët e Kuvendit, organizimi dhe funksionimi, puna e organeve politikëbërëse dhe vendimmarrëse, luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve, integrimi evropian, kontabiliteti dhe buxheti, kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve, të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike.

Gjithashtu, është përfshirë edhe pasuria kapitale dhe jokapitale, informimi dhe shërbimi i qytetarëve, bashkëpunimi me shoqërinë civile, planifikimi urban dhe monitorimi i projekteve urbanistike.

Një muaj paraburgim për të dyshuarin për krime të luftës

PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masën e paraburgimit për të pandehurin D. S., i cili dyshohet se ka kryer veprën penale "krime lufte kundër popullatës civile", në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë. Në një komunikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë thuhet se të pandehurit D. S. i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaji. I pandehuri D. S., 44 vjeç, është arrestuar gjatë fundjavës në kalimin kufitar të Jarinës, në vendkalimin kufitar Kosovë - Serbi. Gjykata Themelore thotë se pala ka të drejtë ankese kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

NATO-ja nis stërvitjen më të madhe në Detin e Zi

BRUKSEL, 7 MAJ - Stërvitja më e madhe të cilën NATO-ja do ta zhvillojë me shtatë aleatë në Detin e Zi, "Mburoja e detit 2018", ka filluar në kryeqytetin e Rumanisë, Bukuresht.
Sipas të dhënave të siguruara nga burime të NATO-s, stërvitja zhvillohet mes datave 6 dhe 9 maj, ndërsa marrin pjesë Turqia, Spanja, Bullgaria, Rumania, Britania e Madhe, ShBA-ja dhe Greqia.
Në kuadër të Grupit Detar të Përhershëm të NATO-s nr. 2, në stërvitje janë përfshirë tre avionë stacionarë detarë, pesë avionë luftarakë dhe 21 anije, raporton Anadolu Agency.
Brenda këtij viti NATO-ja planifikon të realizojë 106 stërvitje, ndërsa pritet që aleatët e saj të marrin pjesë në rreth 180 stërvitje kombëtare dhe shumëkombëshe.

Betohet Putini për të katërtën herë president i Rusisë

Moskë, 7 maj - Vladimir Putini është betuar të hënën në mandatin e tij të katërt president i Rusisë, duke zgjatur pushtetin e tij 18-vjeçar në këtë shtet. Në këtë ceremoni Putini është zotuar se do t'i shërbejë popullit dhe do të punojë për përmirësimin e kushteve për jetesë. Mbështetësit e tij konsiderojnë se Putini ka ngritur shtetin pas një periudhe të vështirë, derisa kundërshtarët e cilësojnë udhëheqjen e tij si autokraci të korruptuar.
Ceremonia e inaugurimit në Kremlin vjen pas fitores së Putinit në zgjedhjet e marsit, për të cilat ai ka thënë të kenë qenë demonstrim i besimit publik, ndonëse kritikët kanë deklaruar se ai proces ka qenë përtej pamjes demokratike.
Kjo ngjarje vjen vetëm dy ditë pasi policia ka ndaluar 1 600 persona, duke përfshirë liderin opozitar Aleksei Navalny në protestat e mbajtura në disa qytete ruse, në të cilat është shprehur pakënaqësi për pushtetin e gjatë të Putinit.
Shumica e të ndaluarve janë liruar, ndërkohë që disa të tjerë do të përballen me seanca gjyqësore, duke përfshirë Navalnyn, i cili është arrestuar nga policia në Moskë.
Në mesin e pakënaqësive është përmendur edhe qasja e Rusisë me Perëndimin, duke përfshirë shkaqet si vendimi i Putinit për aneksimin e Krimesë nga Ukraina më 2014, mbështetjen e separatistëve në lindje të Ukrainës, përfshirjen e supozuar në zgjedhjet amerikane dhe përkrahjen e presidentit sirian Bashar al-Assad.

Në ceremoninë e betimit në mandatin e tij të katërt të presidentit të Rusisë, Putini është zotuar se do t'i shërbejë popullit dhe do të punojë për përmirësimin e kushteve për jetesë

Putini ka përmendur një varg synimesh për mandatin e tij të ri, duke përfshirë uljen e varfërisë në Rusi, modernizimin e infrastrukturës, rritjen e kujdesit shëndetësor dhe transformimin e ekonomisë. "Të mbeturit mbrapa në teknologji është kërcënimi kryesor dhe armiku ynë më i madh", ka thënë ai në adresimin e tij vjetor, disa javë para zgjedhjeve të 18 marsit, në të cilat autoritetet kanë thënë se ka fituar 77 për qind të votave.
Mbetet të shihet nëse Putini do të jetë në gjendje t'i zbatojë këto plane ambicioze, ndonëse një analizë e Bloombergut ka gjetur se Putini nuk ka realizuar një varg premtimesh prej vitit 2012. Rusia ende është duke u përballur me sanksione perëndimore për shkak të rolit të saj në konfliktin në Ukrainë dhe ndërhyrjen në politikën amerikane.
Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ka thënë se Putini planifikon zhvillimin e një varg takimesh pas ceremonisë së betimit dhe nuk do të luajë hokej mbi akull, siç ka bërë pas ceremonisë së vitit 2012.
Putini, 65-vjeçar, ka qenë ushtrues detyre i presidentit në ditën e fundit të vitit 1999 dhe nëse numërohet periudha e tij si kryeministër më 2008-2012, ai është lideri me më së shumti vite në pushtet prej pushtetit të diktatorit sovjetik, Josef Stalin. Ai ishte rizgjedhur në muajin mars me 76.69 për qind të votave, më shumë sesa që kishte fituar më 2000, 2004 dhe 2012 dhe ishte konsideruar me përqindjen më të madhe të siguruar nga ndonjë lider rus të periudhës post-sovjetike.
Ndonëse ka pasur raportime për parregullsi në zgjedhje, duke përfshirë 10 milionë vota false, ato nuk duket të kenë ndikuar në popullaritetin e Putinit. Kundërshtarët e tij kanë thënë se kontrolli i rreptë i Kremlinit dhe media shtetërore ia kanë siguruar atij fitoren, pavarësisht se vëzhguesit ndërkombëtarë kanë thënë se votuesit nuk kanë votuar në mënyrë të sinqertë.
Megjithatë, bazuar në të dhënat e një organizate shtetërore VTsIOM, besimi i rusëve për Putinin ka rënë dukshëm prej kohës së zgjedhjeve, nga 58.9 për qind sa ishte në muajin janar në krahasim me 47.1 për qind në muajin prill.

Britania kërkon që Uashingtoni të mos tërhiqet nga marrëveshja me Iranin

LONDËR, 7 MAJ - Sekretari i Jashtëm britanik Boris Johnson i bëri thirrje presidentit Donald Trump të mos tërhiqet nga marrëveshja bërthamore me Iranin, duke thënë se marrëveshja ka dobësi, por ato mund të trajtohen me kohë.
Boris Johnson, i cili ka ardhur për një vizitë në Uashington, është takuar të hënën me nënpresidentin amerikan Mike Pence dhe me këshilltarin për Sigurinë Kombëtare, John Bolton. Johnson do të përpiqet të ndikojë tek administrata e presidentit Donald Trump, që të mos heqë dorë nga marrëveshja e arritur në vitin 2015 ndërmjet Iranit dhe fuqive botërore për kufizimin e programit bërthamor iranian, në shkëmbim të lehtësimit të sanksioneve.
Presidenti Trump, kritik i shpeshtë i asaj që ai e quan marrëveshje të mangët, ka kërcënuar për anulimin e saj dhe pritet që ai të marrë një vendim për këtë çështje deri më 12 maj. Veç Britanisë, edhe Franca dhe Gjermania thanë se do të vazhdojnë ta ruajnë marrëveshjen bërthamore me Iranin, edhe nëse vendimi i kësaj jave i ShBA-së mund të jetë për refuzimin e saj.
Britania, Kina, Franca, Rusia, Gjermania dhe ShBA-ja negociuan marrëveshjen me Iranin midis pretendimeve se Teherani po punonte për zhvillimin e armëve bërthamore. Irani vazhdimisht i ka mohuar pretendimet e tilla, ndërsa ka theksuar se ka të drejtë ta zhvillojë programin e raketave balistike për qëllime mbrojtjeje.

Kosova merr pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Koreve në Francë

Kori i qytetit të Pejës "Siparantum Choir" të hënën ka udhëtuar për në Nancy të Francës, me ç'rast do të jetë pjesë e Festivalit Ndërkombëtar të Koreve "Nancy Voix Du Monde 2018" në Francë, që mbahet nga data 9-13 maj

PEJË, 7 MAJ (ER) - Kori i qytetit të Pejës në Festivalin Ndërkombëtar të Koreve në Francë do të paraqitet me disa koncerte në lokacionet më të njohura të vendit, si: Temple à Nancy, la salle Erkman à Luneville, Grand Salon de Nancy dhe Place Stanislas à Nancy.
Në këtë festival do të paraqiten edhe Algjeria, Gjermania, Argjentina, Bullgaria, Kili, Ekuadori, Filipinët, RD e Kongos, R. Çeke, Zvicra, Ukraina etj. "Për këtë program ne jemi duke punuar gjatë dhe intensivisht. Ky mund u shpërblye. Edhe pse kori është formuar vitin e kaluar, konsideroj se kemi bërë një punë të madhe dhe e gjithë kjo në baza vullnetare, vetëm për ta pasuruar kulturën dhe vlerat tona. Për këtë gjë u jam falënderues gjithë atyre që na kanë përkrahur drejt qëllimeve tona artistike. Shpresoj se do të kthehemi me paraqitjet tona më të mira nga Franca", ka thënë Fatmir Bajraktari, president i korit.
Kori Siparantum do të paraqitet me vepra të kompozitorëve të njohur botërorë dhe vendorë, si: Whitacre, Bartolucci, Runestad, Gjeilo, M. Mengjiqi, K. Aliçkaj, D. Zeqiri-Nushi, M. Kelmendi etj. "Është kënaqësi për mua si dirigjent të jem pjesë e kësaj ngjarje shumë të rëndësishme ku shteti ynë, Kosova, paraqitet për herë të parë në këtë festival, me ç'rast do të paraqitemi me vepra të repertorit të ndryshëm, duke përfshirë vepra të kompozitorëve të njohur botërorë. Qëllimi kryesor është paraqitja e motiveve dhe vlerave tona kombëtare në këtë festival. Ndihem krenar që shoh flamurin e shtetit tonë në mesin e shteteve të botës në këtë festival që për neve si shtet konsideroj se është një ngjarje shumë e rëndësishme kulturore", ka thënë Memli Kelmendi, dirigjent i korit.
Pjesë e programit do të jenë: Agron Shujaku, piano; Matej Karaqi, vokal; Arita Bajraktari, soprano dhe piano; Bleona Leka, piano; Rexhë Dobrunaj, bas dhe bariton; Erjon Palucaj, vokal; Luan Sapunxhiu, gitarë; Rizah Jahaj, tenor; Blerina Zeka, flaut; Durim Jasharaj, fagot.

Meta pret në takim Nexhmije Pagarushën në 85-vjetorin e lindjes së saj

TIRANË, 7 MAJ (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur të hënën në një takim të veçantë, këngëtaren e mirënjohur Nexhmije Pagarusha. Ai i ka uruar ditëlindjen legjendës së muzikës, duke shprehur admirim për zërin e saj.
Presidenti Meta e ka cilësuar Nexhmije Pagarushën të papërsëritshme dhe mbretëreshë të këngës shqiptare. "Pata sot privilegjin e veçantë t'i uroj ditëlindjen e jetë sa më të gjatë mbretëreshës së këngës shqiptare. Admirim e mirënjohje të thellë, për të gjitha emocionet dhe krenarinë që zëri i saj i ka dhuruar kombit në dekada. Gëzuar ditëlindjen, e papërsëritshmja, artistja jonë e madhe, Nexhmije Pagarusha!", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".
Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka uruar Nexhmije Pagarushën me rastin e

85-vjetorit të lindjes dhe dekorimit nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump. "Diva e këngës, Nexhmije Pagarusha, hyri në mbamendjen e të gjithë brezave, duke lidhur shekujt 20-21 përmes fijeve të arta të muzikës burimore shqiptare. Ajo me 'Bareshën' e famshme dridhi zemrat e adhuruesve të këngës edhe jashtë gjeografisë shqiptare, kudo që u shfaq, duke u dhënë vulën e personalitetit lirik perlave të thesarit shqiptar. Urime për 85-vjetorin e lindjes 'Bilbil i Kosovës'! Urime dekorimi nga presidenti amerikan Donald Trump dhe faleminderit që i ke dhënë shumë shpirt e krenari këtij vendi!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Shpella e Gadimes rihapet për vizitorë

LIPJAN, 7 MAJ (ER) - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) ka njoftuar se problemet e paraqitura ditët e fundit në sistemin elektrik të ndriçimit në monumentin e natyrës me rëndësi të veçantë Shpella e Gadimes, si

pasojë e vërshimeve dhe defekteve me kabllot e furnizimit me rrymë, janë evituar.
AMMK-ja ka bërë me dije se që nga dita e hënë Shpella e Gadimes është e hapur për vizitorë. Problemet u evituan pas angazhimit të një kompanie profesionale nga AMMK-ja, e cila ka identifikuar problemet dhe i ka evituar defektet.
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, si organ menaxhues i Monumentit të Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes", u ka kërkuar falje të gjithë vizitorëve që kanë planifikuar të realizojnë vizita gjatë kësaj periudhe kohore dhe i njofton që tani e tutje Shpella e Gadimes do të jetë e hapur dhe e sigurt për t'i mirëpritur vizitorët e saj. "Kërkojmë mirëkuptim nga të gjithë vizitorët për mbylljen e përkohshme të shpellës, njëherësh ju bëjmë me dije që kushtet brenda shpellës janë specifike dhe kërkojnë mirëmbajtje të vazhdueshme të rrjetit elektrik në shpellë, andaj mbyllja e përkohshme e shpellës në këto raste është e paevitueshme", thuhet në njoftimin e AMMK-së.

Thaçi dekoron tenorin Ramë Lahaj

PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar tenorin e famshëm të Kosovës, Ramë Lahaj, me Medaljen Presidenciale të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Thaçi ka thënë se tenori Ramë Lahaj përmes artit muzikor po shkëlqen kudo në skenat botërore dhe po e afirmon denjësisht emrin e Kosovës. "Kosova ka shumë talente, ka shumë profesionistë që me përkushtim po arrijnë majat e suksesit në arenën ndërkombëtare", ka thënë presidenti Thaçi.
Ndërsa tenori Ramë Lahaj u shpreh i nderuar me ndarjen e kësaj dekorate të veçantë nga presidenti Thaçi. "Ndihem i nderuar sepse shumë njerëz të merituar e kanë marrë këtë dekoratë për këtë dhjetëvjetor të pavarësisë", u shpreh tenori Lahaj. Presidenti Thaçi dhe tenori Ramë Lahaj kanë diskutuar edhe për mundësitë dhe vështirësitë që mund t'i ketë jeta në diasporë për ndërtimin e karrierës profesionale.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	SWANSEA - SOUTHAMPTON	X	ROSS COUNTY - DUNDEE	1	ABERDEEN - RANGERS	3+

Jupa: Besa FamGas, pas Kupës, kërkon titullin

Besa FamGas e fitoi Kupën e Kosovës për herë të pestë radhazi, kurse tash po synon të njëjtën gjë ta bëjë edhe në garën për titull. "Ne i kemi të gjitha mundësitë që ta fitojmë edhe titullin e kampionit, pra ta mbrojmë për të pestin vit radhazi. Do të ishte e shkëlqyeshme të arrijmë një sukses kaq të madhe dhe vështirë se ndonjë skuadër tjetër do ta arrijë në të ardhmen", ka thënë Kastriot Jupa

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 MAJ - Skuadra e Besa FamGas e ka fituar Kupën e Republikës së Kosovës në hendboll, pasi në finale e ka mposhtur skuadrën e Prishtinës me rezultat 31-29. Një ditë pas triumfit për herë të pestë në këtë garë, Kastriot Jupa, një prej më meritorëve në suksesin e ekipit pejan, ka thënë se Besa nuk luajti mirë, por në finale rëndësi ka vetëm fitorja. "Kemi hasur në rezistencë të fortë nga Prishtina, por nuk ishte ndeshja jonë më e mirë. Përkundrazi, kemi bërë shumë gabime në repartin e mbrojtjes. Në finale rëndësi ka fitorja dhe ne e arritëm një gjë të tillë, prandaj jemi shumë të kënaqur që e fitojmë këtë trofe për të pestën herë radhazi", ka thënë Jupa për "Epokën e re".
Besa FamGas e ka fituar trofeun e parë për edicionin 2017\18 falë dy golave diferencë në pjesën e parë (18:16). Këtë epërsi skuadra e drejtuar nga trajneri Arben Muqolli e ruajti edhe në pjesën e dytë dhe në fund e ngrehi lart trofeun e Kupës. Synimet e kësaj skuadre janë ta fitojë edhe titullin e kampiones në elitën e hendbollit të Kosovës. Në rast se Besa e arrin këtë sukses, do të jetë për herë të pestë, sikurse në garën e Kupës. "Ne i kemi të gjitha mundësitë ta fitojmë edhe titullin e kampionit, pra ta mbrojmë për të pestin vit radhazi. Do të ishe e shkëlqyeshme të arrijmë një sukses kaq të madh dhe vështirë se ndonjë skuadër tjetër do ta arrijë në të ardhmen", ka shtuar ai.
Lidhur me dominimin absolut të skuadrës pejane në hendbollin e Kosovës në vitet e fundit, Kastriot Jupa ka deklaruar: "Besën e karakterizon organizimi i mirë i brendshëm dhe një stabilitet financiar që nuk e kanë klubet e tjera. Edhe hendbollistët shumë cilësorë dhe atmosfera brenda e ekipit është e jashtëzakonshme, prandaj të gjitha këto sjellin në fund rezultate".
Në finalen e zhvilluar në palestrën "Karagaçi" në Pejë, Egzon Gjuka me 12 gola ishte më meritori për suksesin e Besës, kurse 10 gola i shënoi Kastriot Jupa. Ndërsa te Prishtina më efikasi ishte Petrit Prekazi me nëntë gola. Nga shtatë gola i shënuan Beni Syla e Deniz Terziqi.

Katër medalje në Shkodër për boksierët e Kosovës

PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Boksierët e Kosovës kanë arritur rezultate të mira në turneun ndërkombëtar "Memorial Vllaznia 2018" në Shkodër, duke fituar katër medalje. Dy medalje të arta i fituan Patriot Behrami dhe Dielli Vranoci, kurse me medalje të argjendta u stolisën Leotrim Rexhepi dhe Armend Neziri.
Leutrim Rexhepi, që e zhvilloi meçin e parë ndërkombëtar, humbi nga boksieri shqiptar me përvojë të madhe, Ardit Murja, por tregoi boks të mirë dhe cilësor. Ndërsa Patriot Behrami në finale tregoi një mjeshtri të boksit dhe teknikë të përsosur dhe bindshëm 3:0 e mposhti boksierin nga Maqedonia Denis Muaremovski (69 kg).
Boksieri tjetër, Dielli Vranoci, e mposhti shqiptarin Spiridhon Ymeri. Gjatë tre raundeve dominoi kundër kundërshtarit dhe në fund fitoi me rezultat 2-1. Në kategorinë deri 75 kg, Armend Neziri i papërvojë në arenën ndërkombëtare, boksoi kundër boksierit më të mirë të Shqipërisë, Arjon Kajoshit dhe bëri një boks të mirë, por në fund është dashur të pajtohet me humbje. Drejtësinë në këtë turne e ndau gjyqtari ndërkombëtar i AIBA-s, Latif Demolli.

MKRS-ja, 7 200 euro për Nishevcin

PRISHTINË, 7 MAJ - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, ka pritur të hënën në takim karateistin Herolind Nishevci, me ç'rast është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për mbështetje financiare të përgatitjes së sportistit për gara. Sipas këtij memorandumi, karateisti Nishevci mbështetet financiarisht me 7 200 euro. Mbështetja financiare bëhet me qëllim të realizimit të synimeve të sportistit për periudhën buxhetore janar-dhjetor 2018.
Ministri Gashi ka thënë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do ta vazhdojë mbështetjen financiare të sportistëve të vendit, duke theksuar se kësisoj po realizohen politikat programore për sportin. Ndërkaq sportisti Nishevci falënderoi ministrin për memorandumin e nënshkruar dhe e përgëzoi për punën që po bën për mbështetje të sportistëve dhe sportit në vend.

Notarët e Kosovës, pa flamur si notarët e tjerë

PRISHTINË, 7 MAJ - Kombëtarja e Kosovës në not ka garuar në fundjavë në kampionatin ballkanik për juniorë, të mbajtur në Sarajevë të Bosnjë e Hercegovinës. Organizatori nuk kishte lejuar Kosovën të paraqitet me flamur, me arsyetimin se Bosnja e Hercegovina nuk e njohin Pavarësinë e Kosovës, derisa Federata e Notit e Kosovës, në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, kishin vendosur të tërhiqen nga kampionati. Për të gjetur një zgjidhje, organizatori vendosi që asnjë kombëtare të mos paraqitet me flamur, për çfarë edhe Federata e Notit të Kosovës pranoi të garojë. Rezultatet më të mira nga garuesit tanë i patën: Dren Ukimeraj dhe Dion Kadriu, të cilët zunë vendet 13 dhe 14 nga 17 garues në disiplinën 200 metra stil i lirë.

Vokrri: FFK-ja vendos në territorin e Kosovës

PRISHTINË, 7 MAJ - Ndeshja "miqësore" Cërvena Zvezda-Graçanica nuk do të zhvillohet këtë vit, pasi Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) nuk e ka dhënë lejen për t'u zhvilluar kjo ndeshje.
Kryetari i FFK-së, Fadil Vokrri, për "KosovaPress" ka treguar në detaje arsyet e ndalimit të kësaj ndeshje, ani pse dy vjet më parë ishte zhvilluar një ndeshje e tillë. "Brohoritjet dhe skanimet e simpatizuesve të Zvezdvës nuk kanë qenë në përputhje me kodin e 'fair-play'-it dhe ka pasur ofendime të llojllojshme si të institucioneve tona të Kosovës, të Federatës dhe të popullatës. Kur ka ardhur kërkesa, ne nuk i kemi dhënë leje dhe e kemi njoftuar edhe UEFA-n, dhe ajo e ka njoftuar edhe Federatën serbe për mosdhënien e lejes. Mendoj se ndeshjet e tilla të karakterit humanitar duhet që edhe sjelljet e spektatorëve dhe të gjithë aktorëve duhet të jenë në përputhje me 'fair play'-n që vitin e kaluar nuk ka qenë dhe kjo është e vetmja arsye që ne e kemi refuzuar lejimin e zhvillimit të kësaj ndeshje", ka thënë Vokrri.
Numri një i FFK-së i ka komentuar edhe deklaratat e drejtorit të Zyrës Serbe për Kosovë, Marko Gjuriq, i cili vendimin e FFK-së e ka quajtur të turpshëm. "Marko Gjuriq është mirë të merret me veten dhe problemet e tyre, sepse kjo nuk është në domenin e tij. Kjo është një ndalesë sportive, edhe pse ndërlidhet me çështjet e sigurisë. Ne i kemi punët e tona dhe ne veprojmë konform nenit të statutit të UEFA-s, i cili thotë se një organizëm, siç është Federata e Futbollit të Kosovës, është autonome në vendimet e saj dhe është i vetmi organizëm i cili organizon gara në tërë territorin e Kosovës", ka deklaruar Vokrri.

Golden State e Houstoni, një hap larg finales

OAKLAND, 7 MAJ - Golden State dhe Houstoni janë vetëm një fitore larg finales së Konferencës së Perëndimit në kampionatin amerikan të basketbollit, NBA.
"Warriors"-i fitoi sfidën e katërt me New Orleansin me rezultatin 112-98, e tani kryeson serinë e përballjeve në 3-1. Ndeshja e pestë do të luhet në "Oracle Arena" të Oaklandit, me Golden State që do të kërkojë ta mbyllë çështjen e kualifikimit përballë publikut të tij. "Pelicans"-i e kishte të pamundur ta përballojë lojën e Golden States, që në periodën e parë krijoi një avantazh prej 15 pikësh.
Në një moment të takimit, New Orleans e reduktoi diferencën në 7 pikë, por Golden State e rriti shumë shpejt ritmin e lojës, duke e thelluar edhe më shumë avantazhin e duke e mbyllur ndeshjen me 26 pikë më shumë se New Orleansi. Njeriu i ndeshjes për "Warriors"-in u bë Kevin Duranti, me 38 pikë, 9 topa në tabelë e 5 asistime, ndërkohë që paraqitje mjaft të mirë bënë edhe Stephen Curry, me 23 pikë e Klay Thompson me 13. Ndërkohë, në gjysmëfinalen tjetër të Konferencës së Perëndimit, Houstoni fitoi sfidën e katërt me Utah Jazzin, 100-87, për ta kryesuar tashmë 3-1 serinë e përballjeve me të. Në "Viviant Smart Home Arena" të Salt Lake Cityt, Houstoni e vendosi diktatin kundrejt vendësve të Utahut që në fillimin e sfidës. Në përfundim të dy periodave të para skuadra teksane krijoi një avantazh prej 10 pikësh, i cili në fundin e ndeshjes shkoi në 13. Protagonist kryesor i sfidës për "Rockets"-at u bë Chris Paul, me 27 pikë e 12 topa në tabelë, ndërsa James Hardeni e mbylli këtë herë takimin me 24 pikë. Sfida e pestë mes Houstonit dhe Utah Jazzit do të zhvillohet të mërkurën në "Toyota Center" të Houstonit.

SHKURT

Barça beson te Valverde

Presidenti i Barcelonës, Josep Maria Bartomeu, në një intervistë për radion "RAC 1", ka konfirmuar se Ernesto Valverde do të mbetet trajner i Barcelonës, pasi e ka fituar titullin dhe Kupën e Mbretit. "Valverde do të jetë trajner i Barcelonës edhe sezonin e ardhshëm. Ai dëshiron të qëndrojë me ne dhe unë në asnjë moment nuk e kam menduar largimin e tij", ka thënë Josep Maria Bartomeu.

Ribery vazhdon kontratën me Bayernin

Ylli i futbollit francez, Franck Ribery, do ta veshë fanellën e Bayern Munchenit edhe për një vit tjetër. Kontrata e 35-vjeçarit me Bayernin përfundonte në fund të këtij edicioni, por ai e ka zgjatur deri më 30 qershor 2019. Ribery është pjesë e Bayernit nga viti 2007, kurse për këtë skuadër ka realizuar 80 gola në 247 ndeshje në Bundesligë. Ribery e ka fituar edhe Ligën e Kampionëve në vitin 2013 dhe po atë vit u shpallë Futbollisti më i Mirë Evropian i Vitit.

Salzburgu, kampion në Austri

Red Bull Salzburgu lë pas zhgënjimin e eliminimit në gjysmëfinalen e Evropa Ligës për ta festuar titullin kampion në Austri. Ekipi i shqiptarit Valon Berishës dominoi 4-1 kundër rivalëve për titull të Sturm Grazit për t'u shpallur kampion për herë të pestë radhazi dhe të 12-n në historinë e klubit. Titulli i Salzburgut është konfirmim i dominimit të ekipit të drejtuar nga Marco Rose, ndërsa po ndaj Sturm Grazit ekipi do ta ketë mundësinë ta fitojë edhe Kupën e Austrisë këtë mesjavë.

Wengeri: Gjithmonë do të jem tifoz i Arsenalit

Arsene Wenger e ka drejtuar Arsenalin në ndeshjen e fundit në shtëpi dhe natyrisht se ka qenë një ndeshje plot emocione për teknikun francez. Pasi të mbyllet sezoni, 68-vjeçari do të largohet nga posti i trajnerit të "Topçinjve", ku qëndroi plot 22 vjet. Skuadra ia bëri një dhuratë të mirë në ndeshjen e fundit si vendës duke e mposhtur Burnleyn me rezultat 5-0. "Mendoj se është mirë të mos flas publikisht për trajnerin e ri sepse nuk jam i përfshirë në këtë gjë. Nuk dua t'i bëj presion klubit për të zgjidhur këtë ose atë sepse nuk dua të kem të bëj me këtë. Trajneri i ri do ta trashëgojë një skuadër që është shumë më e mirë sesa e mendojnë njerëzit. Jam i bindur se bashkimi i kësaj skuadre është shumë i veçantë dhe me lojtarët e rinj të duhur, ky ekip do të sfidojë në sezonin e ardhshëm", ka thënë Wengeri. "Gjithmonë do të jem një tifoz i Arsenalit. Kjo është ajo që na bashkon në secilën qelizë të trupit, këto ëndrra dhe shqetësime. Gjëja pozitive e të qenit tifoz pasi të largohem është se mund t'i bërtas trajnerit të ardhshëm!", ka thënë Wengeri, i cili gjatë kohës si trajner i Arsenalit ka fituar tre tituj të Ligës Premiere dhe rekord prej shtatë trofesh të Kupës FA.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Lirim Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Luigj Gurakuqi" Hatmagje

▶ Ersin Lalosh shpall te pavlefshme diplomën SHMLM "Luciano Motroni" Prizren

▶ Eldin Maznikar shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

▶ Nderim Begolli shpall te pavlefshme diplomën e SHMGJ " Gjon Buzuku" Prizren

▶ Sadifete Gashi shpall te pavlefshme diplomën SHMLM "Luciano Motroni" Prizren

▶ Belkize Oruqaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLM "Luciano Motroni" Prizren

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
GLAVNI CENTAR PORODIČNU MEDICINU
MAIN CENTER OF FAMILY MEDICINE
Nr: 78/018
Data: 02.05.2018
SKENDERAJ

Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Municipal Assambly Skenderaj

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje
Department of Health and Social Welfare
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare –Glavni Centar Porodicne Medicine –Main Family Medicine Center
Nr: 78 / 018 .
Datë : 02./ 05 / 2018 .
Skenderaj

Në bazë tëVendimit të Kryetarit të Komunës se Skenderajt 02 Nr.111/01-0025195/18 të dt. 30/04 / 2018, për lejimin e shpalljes se Konkursit për vendet e lira të punës për 6 (gjashtë) Infermier/e dhe për 1 (një) zyrtar/e Administrativ për nevojat e QKMF-së, në Skenderaj , **e në përpudhje** me nenin 7, 8, 10 paragrafi 1, nenparagrafi 2.1 , nenit 15 paragrafi 1,2 dhe 3 të Ligjit të Punës se Republikës se Kosovës nr. 03/ L- 212 , nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04 /L - 125 , nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) **nr.** 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik , Udheheqesi i Administratës dhe personelit të QKMF –së, në Skenderaj , publikon këtë :

KONKURS
PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE

I.- Titulli i vendit të Punës : Gjashtë (6) Infermier/e të Përgjithshme në QKMF ,
Kategoria dhe grada e vendit të punës
- Koeficienti : 4.80, H- 68 .
- Orari : 40 orë në javë ,
- Kohëzgjatja e Kontratës : Sipas Ligjit të Punës nr. 03/ L-212.

Detyrat dhe përgjegjësitë :
Pranon triazhon dhe informon pacientin , hapë kartelën shëndetësore dhe merr anamnezën orientuese , aplikon terapinë parenteriale ,i.m.iv . sub kutan ,aplikon infuzionet, bënë inhalimin ,përpunimin e plagës ,përcjellë kalendarin e imunizimit , aplikon dhënjen e oksigjenit , bënë audiogramet e nevojshme etj. Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës .Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit dhe Stafit Udheheqes të këtij Institucioni Shëndetësor .

Kushtet e Konkursit :
Kandidati/ja , të cilët konkurojnë për këtë vend të punës , përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj , duhet të këtë përfunduar :

-Bachelor i Infermierisë – drejtimi i përgjithshëm.
-Shkollen e mesme të mjekësisë – drejtimi Infermieri e përgjithshme,
- Kanditati/ja , duhet të këtë Licencën e Punës .

Dokumentet e kerkuara :
- Kopjet e Diplomës se shkollimit të kryer ,
- Kopjen e Licencës se Punës ,
- Çertifikatën e lindjes ,
- Kopjen e Leternjoftimit ,
- Çertifikatën që nuk është i denuar dhe nën hetime ,
- Çertifikatën e mjekut ,
- Çdo dokument tjetër apo çertifikatë trajnimi që kandidati/ja , e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kritereve të përcaktuara më lartë .
- Deshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter ; e deshirueshme .

II.- Titulli i vendit të punës : Një (1) zyrtar/e Administrativ në QKMF – Skenderaj .
Kategoria dhe grada e vendit të punës :
- Koeficienti : 7.20, H- 33.
- Orari : 40 orë në javë ,
- Kohëzgjatja e Kontratës : Sipas Ligjit të Punës nr.03/L- 212 ,

Detyrat dhe përgjegjësitë :
- Mban evidencën e punëtorëve në Librin amëz (amë) si dhe evidencën (dosjen) për punëtor sipas ABC-së .
- Përpilon dhe lëshon Vendime për punëtoret që iu lejohet pushimi vjetor dhe udheheqë evidencën e tyre .
- Është përgjegjes për dosjet e punëtorëve , duhet të përfshijë të gjitha dokumentacionet relevante sipas Ligjit në fuqi .
- I mundëson çdo punonjesi të këtë çasje në dosjen e tij personale dhe i lenë mundësi të korigjojë ndonjë pasaktësi .
- Është përgjegjes për ruajtjen e dokumentacionit të çdo punëtori në QKMF .
- Lëshon Vendime , shkresa , vertetime e tj.
- Kryen edhe punë të tjera sipas profesionit nga lëmia përkatese ,
- Kryhen edhe punë të tjera në bazë të përshkrimit të detyrave të punës së Zyrtar-es/it Administrativ , të parapara sipas Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës të QKMF-së si dhe punë tjera nga lëmia përkatëse, dhe sipas urdherit të Shefit të Shërbimit juridik dhe Administratës . Për punën e vet i përgjigjet Shefit të Shërbimit dhe Stafit Udheheqs QKMF-së, para të cilëve është përgjegjës .

Kushtet e Konkursit :
Kandidati/ja , të cilët konkurojnë për këtë vend të punës , përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj , duhet të këtë të përfunduar :

- Fakultetin Juridik,
- dy vite pervojë pune .

Dokumentet e kerkuara :
- Kopjen e Diplomës të shkollimit të kryer ,
- Dëshminë mbi përvojen e punës ,
- Çertifikatën e lindjes ,
- Kopjen e Letërnjoftimit ,
- Çertifikatën që nuk është i denuar dhe nën hetime ,
- Çertifikatën e mjekut ,
- Deshminë mbi njohjen bazike të punës me kompjuter , e detyrueshme .
- Çdo dokument tjetër apo çertifikatë trajnimi-, që kandidati/ja , e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kritereve të përcaktuara më lartë.

Çdo aplikues duhet të plotësoi dhe dorëzoi dokumentacionin me sa vijon:

- Fletë aplikacionin e plotësuar
- Dokumentacionin mbi përgaditjen dhe kualifikimin profesional / fotokopje / e vertetuar.

Të gjithë kandidatet të cilët hyjnë në listën e ngushtë , do të ftohen në intervist, dhe për datën e mbajtjes se intervistës do të njoftohen me kohë dhe do të intervistohen nga Komisioni Intervistues .

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Administratën e QKMF – Skenderaj (nga ora 8-15) .
Dokumentacioni i cili i bashkangjitet Aplikacionit duhet të jetë fotokopje dhe i njejti nuk këthehet .
Dokumentacioni i cili nuk iu përgjigjet kërkesave dhe specifikave të Konkursit si dhe dokumentacioni i pakompletuar dhe ai që arrinë me vonesë , nuk do të shqyrtohen .

Afati për aplikim është /15 / pesëmbdhjetë ditë , nga dita e shpalljes publike në Gazetë ditore dhe mjete tjera të Informimit .

QKMF–Skenderaj
Udheheqësi i Administratës e personelit
Behram Mehaj , Jurist i Dip.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta –Ministry of Culture, Youth & Sports

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

